



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Rendit Publik

Nr. 8571 Prot., datë 11. 5. 2005

Ministria e Financave

Nr. Prot. 804, datë 17. 6. 2005

Prokuroria e Përgjithshme

Nr. Prot. 142, datë 24. 06. 2005

Ministria e Drejtësisë

Nr. Prot. 3586, datë 20. 06. 2005

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Për

Funksionimin dhe procedurat e punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si dhe të drejtat detyrimet dhe trajtimin e anëtarëve të tij.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 1 të Ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", për përcaktimin e procedurave se punës të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si dhe të drejtat, detyrimet dhe trajtimin anëtarëve të tij.

Udhëzime

1. Dispozita të Përgjithshme.

Organet përgjegjëse për përgatitjen, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë janë:

a).Sektori "për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve NT Drejtësisë.

b) Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

II. Dispozita të Veçanta.

1. Ky udhëzim përcakton mënyrën e funksionimit dhe procedurat e punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, që më poshtë do të quhet "Komisioni".

2. Komisioni është organi përgjegjës për vlerësimin, miratimin, dhe zbatimin e masave të posaçme të Mbrojtjes së* Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

3. Komisioni ka për detyrë të organizoj dhe ushtrojë kontroll fizik e dokumentar mbi programin e mbrojtjes. Gjithashtu kërkon nga zbatuesi informacion mbi Masat e Posaçme të Mbrojtjes së" Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

4. Komisioni për rastet që konstaton se propozimi për vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes ndaj dëshmitarit apo bashkëpunëtorit të drejtësisë nuk është i plotë, ka të drejtë që të kërkojë dokumente ose informacione të tjera plotësuese

5. Komisioni mbi bazën e dokumentacionit dhe informacioneve të paraqitura, nisur dhe nga ekspozimi i rrezikut, aktual konkret dhe serioz, mund të vendosi masa të posaçme mbrojtje të ndryshme nga ato të kërkuara në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

6. Komisioni merre vendime jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë dhe në çdo rast jo më vonë se 30 ditë nga depozitimi i dokumentacionit përkatës dhe i propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm,

7. Aktet dhe çdo informacion për veprimtarinë e Komisionit konsiderohej informacion i klasifikuar.

8. Komisioni përcakton afatin kohor të masave të posaçme të mbrojtjes pa gjate dhe mbas hetimit të çështjes penale. Komisioni përcakton afatin mohon

të masave të posaçme të mbrojtjes jo me pak se 6 muaj dhe jo me shume se 5 vjet. Ky afat vendoset në të njëjtin akt me të cilin përcaktohen masat e posaçme të mbrojtjes.

Ne raste se komisioni nuk shprehet për afatin kohor të masave të posaçme të mbrojtjes, atëherë masat e posaçme të mbrojtjes zbatohen nga Sektori për mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për një afat kohor prej 1 (një) viti që nga dita e miratimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

9. Komisioni do të zgjasë masat e posaçme të mbrojtjes duke përcaktuar një afat të ri kohor në qoftë se e shikon të arsyeshme dhe mbi bazën e dokumentacionit që disponon për këtë rast.

Komisioni në zbatim të neneve 19 e 20 të ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004 "Të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", miraton ndryshimin, revokimin, ose përfundimin e zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes,

10. Mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë janë të vlefshme kur janë të pranishëm tre anëtarë të' tij .Vendimet e tij janë të vlefshëm kur miratohen nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

11. Komisioni bashkëpunon me Komisionet analoge të vendeve të tjera për këmbimin e përvojës në fushën e programeve të mbrojtjes.

12. Aktet, dokumentacioni dhe çdo informacion që lidhet me aktivitetin e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë konsiderohet informacioni i klasifikuar që mbahet dhe administrohet nga Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

13. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë njofton personat e interesuar për Vendimin e Komisionit mbi propozimin.

14. Në mbledhjet e Komisionit mund të marrin pjesë edhe Drejtori i Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, varësi të cilit është edhe Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

15. Komisioni për punën që kryhen përfiton shtesë mbi pagë. Shtesa mbi pagë jepet nga institucioni nga i cili ose për shkak të të cilit është emëruar Kryetari dhe anëtarët e këtij Komisioni. dhe varion : Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë 20 000 (Njzete mije) lekë në muaj, dhe anëtarët e Komisionit 15 000 (Pesëmbëdhjete mije) lekë në muaj dhe jepet nga institucioni nga i cili është emëruar Kryetari dhe anëtarët e këtij Komisioni.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë .

16. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 01.05.2005


Ministri i Rendit Publik
Igli TOSKA

Prokurori i Përgjithshëm

Theodhori SOLLAKU




Ministri i Drejtësisë
Fatmir KHAFAJ

Ministri i Financave
Arben MALAJ

